

326_Tietoa karanteenipäätöksen saaneelle
[ALBANIA]

Informacione për marrësin e vendimit për karantinë

Kemi marrë informacionin se keni qenë të ekspozuar personit të infektuar me koronavirus COVID-19 dhe për këtë arsye ju caktohet karantina. Me karantinë nënkuptohet kufizimi i lirisë të lëvizjes së personit të shëndoshë. Kështu pengohet infektimi eventual i personave tjerë nga ana e bartësit të virusit që nuk ka fare simptome të sëmundjes. Vendimi për karantinë është bërë sipas Aktit infektiv.

Kohëzgjatja e karantinës

Kohëzgjatja e karantinës ju tregohet pasi që të urdhnoheni të qëndroni në karantinë. Karantina zakonisht zgjatë 14 ditë nga rasti i fundit i ekspozimit.

Të gjithë të ekspozuarve koronavirusit drejtohen në testim gjatë kohës së karantinës. Rezervoni kohën për testim brenda 4-5 ditëve nga ekspozimi. Edhe nëse rezultati i testit është negativ – karantina vazhdon. Nëse rezultati është pozitiv, pra jeni infektuar me koronavirusin, do të vendoseni në izolim. Për këtë do të merrni udhëzimet e veçanta.

Përveq testit të përmendur më parë, lajmërohuni pa vonuar për testin e koronavirusit nëse gjatë karantinës ju lajmërohen simptome të koronës, edhe nëse janë të lehta.

Si në karantinë ta rezervoj kohën për koronavirusitest?

Nëse nuk keni simptome, rezervoni kohë për test duke telefonuar këshilltoren për koronavirusin, t. 09 310 10024 (çdo ditë nga ora 8–18). Mund të rezervoni kohë për veten tuaj apo për fëmijën nën 15 vjeçe në adresën omaolo.fi nëse në aplikacionin Koronavilkku keni marrë lajmërimin për ekspozim ose keni marrë koodin e përcjelljes masive.

Nëse keni simptome, rezervoni kohën për test duke bërë korona-vlerësimin në adresën omaolo.fi apo duke telefonuar këshilltoren për koronavirus. Si prind mund të rezervoni kohën edhe për fëmijët nën moshën 15 v.

Në raste urgjente kur Këshilltorja për koronavirusin është mbyllur mund të telefononi Ndhimën kujdestare, t. 116 117.

Si duhet të veproni në karantinë?

Gjatë karantinës duheni ti shmangeni kontakteve me personat jashtë amvisrisë së juaj. Kohën e karantinës duhet ta kaloni në banesën e juaj. Mund të dilni jashtë nëse nuk i afroheni njerëzve tjerë. Për shembull, nuk guxoni të shkoni në vend të punës, në shkollë, në kopësht, në hobi, në shitore dhe as në barnatore sepse në këto vende është vështirë ti shmangeni kontaktit të afërt. Vizitorët nuk guxojnë të vijnë te ju dhe ushqimin duhet ta porositni në shtëpi.

Personat e afërt me ju të cilët nuk kanë qenë në kontakt direkt me të sëmurin, mund të jetojnë normalisht. Atëherë të afërmit nuk janë në karantinë për dallim nga personi që është urdhëruar të qëndron në karantinë. Të afërmit e personit të vendosur në karantinë nuk shpërndajnë infeksionin me virusin korona.

Nëse askush nuk mund të ju sjellë ushqimin dhe barnat, mund të kontaktoni telefonin e shërbimeve sociale me korona-numrin 09 310 21175.

Kompenzimi i humbjes së pagës

Humbjet e shkaktuara nga qëndrimi në karantinë kompenzohet në formë të mëditjeve të sëmundjes infektive. Këto mund ti kërkonin nga Enti pensional kombëtar (Kela). Si shtesë aplikacionit do të merrni vendimin për karantinë të shkruar nga mjeku i sëmundjeve infektive në qytetin Helsinki. Vendimi për karantinë ju dërgohet në letër rekomande ose automatikisht me e-mail të koduar. Aplikacionin duhet ta dërgoni në Kela brenda dy muajve nga dita kur jeni urdhëruar të qëndroni në karantinë.

Mëditjet e sëmundjes infektive kompenzojnë në tërësi humbjet e pagës të shkaktuara nga qëndrimi në karantinë. Mëditjet e punëtorit përcaktohen sipas pagave të cilat do ti kishte marrë nëse kishte qenë në punë. Mëditjet e ndërmarrësit përcaktohen në bazë të të ardhurave YEL ose MYEL vjetore në kohën kur ka filluar të mungon nga puna. Prindi mbikqyrës i fëmijës së moshës nën 16 vjeçe ka të drejtë në mëditjet e sëmundjes infektive nëse fëmija është urdhëruar të qëndron në karantinë dhe prindi nuk mund të punon.

Nënshtetasi i shteteve të BE, shteteve të EEA apo Zvicrës që punon në Finlandë mund të merr paratë ditore të sëmundjes infektive edhe nëse nuk bën pjesë nën sigurimin shëndetësor të Finlandës.

Informacione tjera gjeni në adresën www.kela.fi/tartuntatauti.

Karantina duhet të respektohet

Urdhëri i zyrtarit të sëmundjeve infektive për karantinë duhet të respektohet gjithësesi. Sipas Ligjit të Finlandës për shkeljen e karantinës, edhe nëse me veprimin e juaj nuk infektoni askend, mund të denoheni me xhobë për shkeljen e masave mbrojtëse shëndetsore ose me denim burgimi deri në tre muaj burg.

Simptomet e korona-infeksionit

Nga marrja e infeksionit deri te çfaqja e simptomeve zgjatë 1–14 ditë, zakonisht 5–6 ditë. Siptomet tipike të sëmundjes të virusit korona për shembull janë: temperaturë e lartë, kollitje, kokëdhimbje, vjellje, barkqitje, dhimbje muskujsh, dhimbje fyti, rrjedhje e hundës, gulçim, humbje e ndjenjes së erës dhe shijes.

Informacione tjera për karantinën gjeni në adresën: www.hel.fi/koronavirus